

Shezai RROKAJ
LIGJI PËR GJUHËT NË MAQEDONINË E VERIUT DHE GJUHA
SHQIPE

Abstrakti: Shumë shtete në Ballkan mbrojtën dhe stimuluan me zell të pazakontë ideologjinë e “shteteve etnikisht të pastra”, që binte ndesh me përkatësinë komb-shtet të vetë realiteteve të këtij areali. Pos kësaj, edhe pas viteve '90, në disa shtete mungojnë ende vende-vende ndjenja etnike frikëkallëse, ku lidershipi politik ka prirje ta deformatojë parimin demokratik të shtetit të së drejtës nëpërmjet shfrytëzimit të përkatësisë etnike për qëllime pragmapolitike si dhe duke nxitur nacionalizmin si ideologji dhe si mjet për të arritur fitore politike për marrjen e pushtetit dhe qeverisjen e vendit.

Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, e ratifikuar me ligjin nr.8496, datë 3.6.1999 dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut të cilat, ndonëse jo detyruese për shtetet që i kanë nënshkruar, këshillojnë hartimin e ligjeve specifike, ku objektivi duhet të jetë përmirësimi i kuadrit ligjor dhe politikave për mbrojtjen e pakicave.

Ndërsa koncepti element shtetformues i ravijëzon shqiptarët si pjesë e domosdoshme për qenien e shtetit, pa të cilët nuk mund të jetë shteti kudo, në gjithë shtrirjen shtetërore, si në nivel qendror dhe në atë vendor, në fakt, koncepti pakicë kombëtare në Ligj tkurret në vetëm përfitim të drejtash në nivel të vetadministrimit lokal dhe vetëm aty ku shqiptarët janë jo më pak se 20% në qeverisjen vendore. Ndërkaq, popullsia e një ‘komuniteti etnik’ me tiparin element shtetformues e bën krejt të dallueshëm atë prej emërtesës gjithëpërfshirëse ‘pakicë kombëtare’, sepse epërsia e madhe numerike brenda popullsisë së shtetit i jep kësaj kombësie një avantazh cilësor që kushtëzon qenien dhe funksionimin e vetë shtetit si emërtesë.

Jam i mendimit se e vetmja zgjidhje e drejtë do të kishte qenë njohja e përdorimit të gjuhës shqipe në gjithë shtrirjen shtetërore, pavarësisht faktit nëse në disa komuna ata janë më pak ose më shumë se 20%, dhe ky kriter të mos ishte kushtëzues për komunat ku ka shqiptarë me më pak se 20%. Kësisoj Ligji duhet të parashikojë në nivel vendor që, aty ku përmbushen kushtet sipas ligjit për Arsimin Parauniversitar në RMV për mësimdhënie në gjuhën shqipe, ajo të realizohet pavarësisht faktit nëse plotësohet apo jo në atë komunë kriteri numerik 20%.

Fjalë kyçe: Ligji, gjuhë shqipe, pakicë kombëtare, element shtetformues, Konventë kuadër, Maqedonia e Veriut. Marrëveshja e Ohrit.

1. Hyrje

Shoqëritë shumetnike ballkanike e më gjerë e kanë gjithnjë dhe më të nevojshme trajtimin e sfidave të integritimit me të cilat përballlet sot bashkëjetesa e popujve, e kulturave dhe e traditave të ndryshme të vendeve tona. Popujt e këtyre vendeve kanë përjetuar si të mirat që vijnë prej bashkëjetesës e mirëkuptimit ashtu edhe të këqijave që vijnë prej përplasjeve e konflikteve. Ndaj kjo përvojë e gjatë duhet të shërbejë për të adresuar sfidat e shoqërive tona me qëllim për të ndërtuar të ardhmen e përbashkët mbi parime të bashkëjetesës, fqinjësisë së mirë dhe vlerësimit të kulturave dhe traditave të njëri-tjetrit si pasurim i ndërsjellë. Shoqëritë demokratike priren

drejt bashkëjetesës ku tjetri (kupto etnia) nuk shihet më si diçka e huaj dhe e dëmshme, por si një vlerë e shtuar dhe përfitim i dyfishtë.

Është i vërtetë fakti se me krijimin e shteteve të Ballkanit lindi edhe nacionalizmi si ideologji, që duket se në këtë rajon u zhvillua më shumë se në çdo pjesë tjetër të Evropës. Shumë shtete në Ballkan mbrytën dhe stimuluan me zell të pazakontë ideologjinë e "shteteve etnikisht të pastra", që binte ndesh me përkatësinë komb-shtet të vetë realiteteve të këtij areali. Këtë frymë e ushqeu herë në mënyrë të drejtpërdrejtë e herë tërthorazi edhe ideologjia komuniste në shumë prej vendeve të Ballkanit e cila, në mjaft raste, i fryu zjarrit nationalist të përplasjeve konfliktuese të etnive brenda shteteve. Pos kësaj, edhe pas viteve '90, në disa shtete mungojnë ende vende-vende ndjenja etnike frikëkallëse, ku lidërshipi politik ka prirje ta deformojë parimin demokratik të shtetit të së drejtës nëpërmjet shfrytëzimit të përkatësisë etnike për qëllime pragmapolitike. Janë të shumta rastet e të përdorurit të nacionalizmit si ideologji dhe si mjet nga partitë politike për të arritur fitore politike për marrjen e pushtetit dhe qeverisjen e vendit. Një dukuri e tillë ka ndodhur në disa vende ballkanike e më gjerë, por ajo është më e theksuar në MV shumetnike, ku për shumë kohë supremacia etnike, kulturore, gjuhësore e fetare ka cenuar të drejtat qytetare të kombësive të tjera, sidomos të shqiptarëve, të cilët de jure dhe de facto janë parë si qytetarë të dorës së dytë. Përveç retorikës politike edhe kuadri ligjor kushtetues e ai normativ në tërësi e kanë dëshmuar këtë fakt.

2. Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe gjendja gjuhësore në RMV.

Ndryshe nga kontinentet e tjera, në raport me sipërfaqen Evropa shpërfaq një mozaik shumëkulturor dinamik prej gati 220 gjuhë e kultura, që gjëlljnë në një areal politik prej 51 shtetesh, bashkë me Kosovën. Bashkëjetesa e këtyre popujve, e gjuhëve dhe kulturave nuk ka qenë e lehtë në rrjedhë të historisë, porse koncepti për Evropën e bashkuar i shteteve ballkanike, bashkë me ëndrrën e shqiptarëve në këto troje për qenë pjesë e integruar e saj ka rritur vizionin për bashkëjetesë dhe në respekt të të drejtave gjuhësore, fetare, kulturore të etnive të tjera, duke i konsideruar ato si vlerë e shtuar, si urë miqësie dhe si fakt i pamohueshëm historik i realitetit të vendeve të gadishullit.

Ky vullnet për bashkëjetesë dhe respektim të pakicave politikisht dhe juridikisht përqaset me atë çka parashikon Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, e ratifikuar me ligjin nr.8496, datë 3.6.1999 dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut të cilat, ndonëse jo detyruese për shtetet që i kanë nënshkruar, këshillojnë hartimin e ligjeve specifike, ku objektivi duhet të jetë përmirësimi i kuadrit ligjor dhe politikave për mbrojtjen e pakicave.

Fryma e kësaj Konvente është mbrojtja e të drejtave të pakicave dhe garantimi i ushtrimit të të drejtave specifike të njeriut për çdo person që i përket një pakice shtetërore, duke theksuar nxitjen e identitetit dallues të tyre si tipar thelbësor i një shoqërie të integruar, e cila

garanton edhe me ligj të drejtën natyrore të qenies njerëzore: mosdiskriminimin dhe barazinë e plotë të shtetasve përballë të drejtave njerëzore.

Mirëpo, pa i mohuar kontributet shtetërore dhe individuale në këtë lëmë, mendoj se hartimi dhe sidomos zbatimi i ligjeve të tilla kërkon pikësëpari një emancipim shoqëror demokratik të shoqërisë në tërësi dhe të lidërve politike vendimmarrës në veçanti. Kërkon gjithashtu frymë tolerance dhe vetëdijësimi mbi bazën konceptit se etnitë e ndryshme brendashtetërore nuk duhen parë si burim konflikti, por si sinergji pasurimi të ndërsjellë. Të përdorurit e konceptit të dominimit numerik të popullsisë brenda shtetit si supremaci gjuhësore, kulturore dhe fetare, që është shpërfaqur rëndomë nëpërmjet ideologjisë nacionaliste, nuk i ka shërbyer idesë së bashkëjetesës mbi bazën e parimit të së drejtës natyrore të njeriut për gjuhën, kulturën dhe fenë e tij. Përpos cenimit të së drejtës së individit ky koncept ka kufizuar edhe pjesëmarrjen aktive dhe marrjen e përgjegjësisë të qytetarëve të kombësisë tjetër në mirëqeverisjen e punëve të shtetit. Përkundër këtij fakti, mbështetja në hulumtime të reja dhe statistika zyrtare që vijnë nga institucione si: akademitë, qendra studimore shkencore, katedra universitetesh, institute kërkimore në fushën e problematikave sociale, ekonomike e kulturore, të cilat janë objektive në trajtimin e këtyre realiteteve dhe japin rezultate reale, të pritshme dhe të besueshme, janë rruga që duhet të ndiqet për të mënjeluar deformime me një vilar pasojash sociale.

2.1. Problematika e konceptit 'pakicë kombëtare'

A është i drejtë, i plotë, gjithëpërfshirës dhe shkencërisht i përligjur koncepti 'pakicë kombëtare' për realitetet etnike në RMV, ku përfshihen shqiptarët, bullgarët, serbët, vllahët, turqit boshnjakët e ndonjë komunitet tjetër? Në fakt, deri më sot në literaturën studimore është folur për minoritete kombëtare, me të cilat identifikohen shqiptarët, bullgarët dhe serbët, kurse vllahët, romët, turqit dhe boshnjakët janë identifikuar si pakica etno-gjuhësore. Kjo ndarje, e cila mbështetëj mbi kritere historike, gjuhësore e kulturore, është eliminuar në ligj, përmes përdorimit të termit ombrellë pakicë kombëtare (alias gjuhë komuniteti). Futja nën një ombrellë është një deformim shkencor historik, etnik, kulturor, gjuhësor e gjeografik, i vetë këtyre 'komuniteteve' dhe i raportit të tyre me entitetin kombëtar, e bërë kjo kinse prej pragmatizmit simplist të plotësimit të këtij prioriteti të vënë si kusht prej Konventës Kuadër. Në fakt, në qasjen historike dhe në traditën shtetformuese termi minoritet parakupton një pakicë kombëtare që ka vijimësi territoriale me trungun amë, në dallim nga pakicat e tjera që nuk kanë vijimësi territoriale, por ekzistojnë në formën e enklavave apo të shpërndara në territorin indigjen. Kurse elementet e përbashkëta identifikuese të pakicave kombëtare dhe minoriteteve mbeten gjithsesi gjuha, kultura, feja si dhe numri i vogël i tyre në raport me popullsinë shtetformuese, që shkon përreth 1 deri në 3%, pak më shumë ose më pak.

Bërja bashkë e të gjitha etnive u jep të njëjtin status emërtese si pakicë kombëtare edhe romëve edhe vllahëve, turqve, boshnjakëve etj., të cilët nuk kanë ose nuk ruajnë lidhje amësie territoriale me një komb të caktuar, por janë trajtuar si produkte historike etno-gjuhësore, dhe

kjo gjë krijon një problem shkencor konceptual në ligj. Këto lloje pakicash etnike trajtohen në literaturën shkencore si pakica ergo dachlos (pa çati), një term i marrë nga fusha e sociolinguistikës.

Mendimi i shprehur rëndomë se kinse Konventa Kuadër ka vetëm një sintagmë për këto lloje komunitetesh dhe i trajton si pakica kombëtare është i pavërtetë jo vetëm prej faktit se Konventa nuk është detyruese, por vetë ajo e lë të hapur hartimin e ligjeve të veçanta nga shtetet nënshkruese në përputhje me veçoritë e vendeve ku përfshihen këto komunitete. Mjafton të përmendim rastin e arbëreshëve tanë në Itali, të cilët nuk quhen pakicë kombëtare, por pakicë gjuhësore me ligjin 482. Ndërkaq, popullsia e një 'komuniteti etnik' me tiparin element shtetformues e bën krejt të dallueshëm atë prej emërtesës gjithëpërfshirëse 'pakicë kombëtare', sepse epërsia e madhe numerike brenda popullsisë së shtetit i jep kësaj kombësie një avantazh cilësor që kushtëzon qenien dhe funksionimin e vetë shtetit si emërtesë.

3. Dallimi pakicë kombëtare/element shtetformues

Prej pohimit të mësipërm mund të shtrohen disa pyetje. A janë pakicë kombëtare apo element shtetformues shqiptarët në RMV? Cili është dallimi midis konceptit pakicë kombëtare dhe të konceptit element shtetformues?

Po të kundrohet me kujdes realiteti juridik i shqiptarëve prej Marrëveshjes së Ohrit e këtij ai i njeh shqiptarët në RMV si element shtetformues. Por duket qartë se ky fakt juridik kushtetues nuk është reflektuar sa dhe si duhet te Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (ose Ligji për Gjuhët), ku shqipja nuk veçohet prej gjuhëve të pakicave (shih gjuhë komuniteti), por përmbledhet nën të njëjtën ombrellë emërtese si gjuhët e kombësive të tjera. Siç do të përshquhet më tej në këtë qasje Ligji për Gjuhët ka vendosur kriterin numerik 20%, me të cilin bëhet një dallim në disa të drejta që kombësitë përkatëse i fitojnë në nivel të qeverisjes qendrore dhe atë vendore, porse ai është mëdyshas për sa i përket dallimit në aspektin cilësor pakicë kombëtare/element shtetformues. Ligji hapërdahet në një sërë paqartësish shkencore konceptuale që i kemi këqyrur qysh prej Preambulës ligjore e në vijim gjatë shtjellimit të përmbajtjes, ku gjithçka sheh një ndërnyje tinëzore mes të drejtave gjuhësore të këtyre kombësive si në nivel qendror ashtu edhe në atë të vetadministrimit lokal. Më shqip kjo do të thotë se ndërsa koncepti element shtetformues i ravijëzon shqiptarët si pjesë e domosdoshme për qenien e shtetit, pa të cilët nuk mund të jetë shteti kudo, në gjithë shtrirjen shtetërore, si në nivel qendror dhe në atë vendor, kurse në fakt, koncepti pakicë kombëtare në Ligj tkurret në vetëm përfitim të drejtash në nivel të vetadministrimit lokal dhe vetëm aty ku shqiptarët janë jo më pak se 20% në qeverisjen vendore.

3.1. Si përcaktohet numerikisht 20%-shi?

Një nga parimet e Konventës Kuadër përcakton se institucionet publike në nivel qendror dhe vendor mbledhin të dhëna në lidhje me identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare, bazuar në të drejtën e vetidentifikimit të këtyre personave dhe në dokumentacionin

e gjendjes civile, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale të vendeve përkatëse.

Mirëpo kriteri i vetëdeklarimit apo vetidentifikimit është i pamjaftueshëm për të qartësuar e përcaktuar qenësinë si pakicë, apo edhe si element shtetformues, po të kemi parasysh realitetin ballkanik, ku mjaft qytetarë për arsye të pragmatizmit për mbijetesë po ndërrojnë nënshtetësi, kombësi, emër e fe, siç është, bie fjala, rasti i fundit me pasaportat e Bashkimit Evropian (maqedonas dhe shqiptarë që vetdeklarohen si bullgarë për hir të marrjes së pasaportës bullgare). Ndaj është e domosdoshme që kriterit të vetëdeklarimit t'i shtohet në kontekstin e shtetit të MV, por edhe në shtete të tjera ballkanike, jo vetëm kriteri i verifikimit mbi bazën gjendjes civile, por edhe kriteret historike e gjeografike që hedhin dritë mbi përkatësinë e tyre duke u mbështetur në të dhëna mbi usus-in gjuhësor, kulturor e fetar rrënjësor.

Ballkani në tërësi dhe në mënyrë të veçantë RMV, për këto çështje nuk mund të mbështeten vetëm te censusi, sido që ai është një metodë vetëdeklarimi gjithandej e përdorur sot për të marrë të dhëna të ndryshme të popullsisë, përfshirë edhe përkatësinë gjuhësore. Ndërkaq, edhe vetë censusi në RMV është kryer para gati dy dekadash, gjë që qysh atëbotë, me lëvizjet e mëdha migratore, por veçanërisht me kompleksin nacionalist të mendësisë së qeverisjeve të kohës, medoemos sot paraqet një realitet shifrash të ndryshuar. Si edhe për shtete të tjera, popullsitë e RMV nuk i kanë shpëtuar trysnisë së dy faktorëve të rëndësishëm: nga njëra anë, ideologjizmit nacionalist, që lidhet me supremacinë dominuese të etnisë kryesore ndaj etnive numerikisht më të vogla dhe, nga njëra tjetër, pragmatizmit utilitarist të globalizmit, ku qytetarët ndërrojnë edhe nënshtetësinë e madje edhe etninë në këmbim të një pasaporte të një vendi të BE-së, si bie fjala, rasti i mësipërm me pasaportën bullgare etj.

4. Dallimi nënshtetas/rezident

Një çështje që ka ngjallur mjaft debate dhe hamendësi, me të cilën qeverisjet në fuqi kanë luajtur tinëzisht, lidhet me faktin sesi kryhet censusi dhe sesi përftohet e trajtohet ky 20%-sh i popullsisë së kombësisë tjetër nga kundrimi i koncepteve nënshtetas/resident në RMV. Si funksionon ky kriteri numerik, sa realist dhe i besueshëm është nga këndvështrimi nënshtetas/resident? Është e qartë se kur realizohet censusi për regjistrimin e popullsisë ai bëhet në funksion të nënshtetësisë dhe jo thesht të vendbanimit, sidoqë në planin praktik këto dy realitete ndërthuren ngushtë me njëri-tjetrin në territor. Disa vende në Evropë e më gjerë njohin vetëm një nënshtetësi për qytetarët e tyre, disa të tjera edhe më shumë se një. Në këto raste qytetarët konsiderohen të përfshirë në kriterin numerik, pra edhe të 20%-shit në shtetet përkatëse si dhe gëzojnë të drejtën e të zgjedhurit dhe zgjedhësit në këtë shtet. Në të kundërt, kur një qytetar mund të ketë dy vendbanime brenda një shteti, pra kur është dy herë rezident, ose mund të jetë nënshtetas maqedonas, por përkohësisht është rezident në një shtet tjetër, në kësi rastesh 20%-shi si kriteri nuk ka lidhje me rezidencën, por vetëm me nënshtetësinë, domethënë, qartësisht me mbajtjen ose jo të një Karte Identiteti të vendit përkatës.

Qartësimi i këtij kriteri sqaron prirjet deformuese të një pjese të vendimmarrësve, e cila e rrit fiktivisht numrin 20%, duke marrë si fakt disa vendbanime brenda një shteti, por sidomos një pjesë tjetër syresh, e cila faktin e lëvizjes së madhe migratore të shqiptarëve jashtë RMV po e përdor si argument të mosplotësimi të 20%-shit si kriter numerik të qenies element shtetformues. Megjithatë, siç do ta shohim më poshtë, çështja e kriterit numerik 20% në pikëpamje të përfundimit të së drejtës është një përcaktim që ka mëdyshjet e veta shkencore dhe varet nga faktorë zhvillimorë të larmishëm. Shumëkush do të ishte pak bindës shkencërisht për argumentat që do të sillte mbi këtë shifër, e cila është një gjetje grossomodo e mbështetur në një sërë faktorësh socialë zhvillimorë për të përligjur të drejtat që duhet të kenë qytetarët e përkatësisë etnike në fjalë. Po ta shtronin problemin ndryshe, bie fjala, se çfarë dallimi substancial do të përbënte një kriter numerik 18%, 19% apo 21%, 22% etj., atëherë do të kuptonim se në pikëpamje të së drejtës së qytetarit shifra është një gjetje institucionale e mbështetur në disa fakte zhvillimore relevante, por jo me domosdo mbi bazën e një përligjeje shkencore ad hoc.

Këtu çështja vjen e bëhet më komplekse dhe ngërthen njëherazi një sërë problematikash. Është komplekse për shumë nga argumentet që u përmëndën më më lart, si ata numerikë ashtu edhe ata ideologjikë, socialë, pragmatistë etj. Në thelb, siç u theksua në hyrje, çështja kryesore në këto qendime dhe përcaktime mbeten kryesisht faktorët zhvillimorë në shoqëri me demokraci funksionale, si: faktorët historikë, demografikë, socialë, kulturorë, ekonomikë, politikë, që kanë ndikim në rritjen e nivelit emancipues të bashkëjetesës dhe të tolerancës midis popullsisë etnike brenda një shteti shumetnik. Sa më demokratike, të emancipuara e tolerante karshi njëra-tjetrës bëhen shoqëritë tona aq më të brishtë dhe bindës në pikëpamje të së drejtës bëhen kriteret numerikë, si rasti në fjalë. Këto kriteret numerike vijnë e zbehen kuptimisht kur etnitë, gjuhët, kulturat, dhe fetë e popullsisë të ndryshme bashkëjetojnë; kur ato japin dhe të marrin si dhe pasurohen në mënyrë të ndërsjellë. Izolimi ndaj njëra-tjetrës, kundërvënja midis tyre, ksenofobia apo supremacia e pushtetit etnik të popullsisë numerikisht më të madhe janë bërë përherë burim konflikti dhe përplasjesh etnike prej të cilave të humbur kanë qënë të gjithë, pavarësisht shkallës së pasojës.

5. Përdorimi i gjuhës amtare si e drejtë natyrore dhe Marrëveshja e Ohrit

Duke e këqyrur ligjin në tërësi, nuk mund të mos shtrohen disa pyetje si, bie fjala, përse pati një ekzaltim bjerraditës të lidërshit politik shqiptar në të tria shtetet, i cili, në mënyrë të çmeritur, miratimin e Ligjit për Gjuhët e cilësoi si fitore të shqiptarëve, kur asëll ky fakt është thjesht një e drejtë natyrore e qenies njerëzore, e sanksionuar në konventat ndërkombëtare dhe që përbën vetë thelbin e demokracive institucionale? Së dyti, a u arrit me këtë ligj gjë tjetër më shumë se ajo që, shumë vite më parë, u njoh me emrin Marrëveshja e Ohrit (Marrëveshja Kornizë e Ohrit 2001) midis partive politike në Maqedoni? Së treti, dhe më kryesorja, a ishte realisht fitore?; a ua ktheu ky ligj shqiptarëve atë që u takon, si popullsi shtetformuese?

Ta themi pa drojë në çast se klasa politike maqedonase, përfshi edhe partitë shqiptare, duhet të bënin një mea culpa të madhe për zbatimin e vonuar të një detyrimi ligjor që vinte si detyrim prej Marrëveshjes Politike të Ohrit. Sipas ish-ambasadorit James Pardew, i cili u mor posaçërisht me Marrëveshjen e Ohrit, në librin e tij *Peacemakers. American Leadership and the End of Genocide in the Balkans* (2018) thekson se dy problemet kryesore të kësaj Marrëveshjeje kanë qenë zyrtarizimi i gjuhës shqipe në tërë territorin e Maqedonisë dhe kontrolli i policisë të bëhet nga komunat dhe jo nga Ministria e Punëve të Brendshme, siç vijon të jetë edhe tani.

Marrëveshja e Ohrit solli ndryshimin e Kushtetutës së vitit 1992, ku gjuha shqipe dhe gjuhët e tjera jomaqedonase as nuk përmëndeshin. Në amendamentin V u shtua përdorimi i gjuhëve të “komuniteteve”, ose më saktë: “Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve, është gjithashtu gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, siç është përcaktuar me këtë nen” (Amendamenti V, neni 1, paragrafi 2 i Kushtetutës së RM-së). Në aspektin juridik, me ndryshimin kushtetues të vitit 2001, gjuhët e komuniteteve, fitojnë statusin e gjuhës zyrtare kur ato janë mbi 20%. Ipso facto, meqenëse shqiptarët në shtetin maqedonas si dhe në shumë komuna janë mbi 20%, gjuha shqipe bëhet de jure gjuhë zyrtare. Gjuhë zyrtare, po si, ku?, gjithandej në hapësirën shtetërore?, pra edhe në nivel qendror apo vetëm në atë vetadministrimit lokal, ku realizohet 20%-shi? Po në ato komuna ku përqindja e popullsisë shqipfolëse është inferiore (nën 20%)? Këtu lind edhe problemi.

Para se të qartësojmë këtë çështje mjaft të rëndësishme më duhet të pohoj pikësëpari se nga ky këndvështrim mund të themi qartas se te Ligji për Gjuhët në RM-së nuk kemi asnjë avancim substancial përtej çfarë parashikohej në këtë Marrëveshje shumë vite më parë. Nëse për vetë kohën dhe kushtet e pas luftës kur u nënshkrua, Marrëveshja mund të konsiderohej si hap ndjellmirë për bashkëjetesën ndëretnike në Maqedoni, sot mund të themi se ky Ligj dhe kjo Marrëveshje shihen ende si një “lëshim”, që u është bërë shqiptarëve prej qeverisjeve maqedonase po të kemi parasysh të drejtat natyrore të popullsisë të ndryshme në shtetet me përfaqësi ndëretnike, që i përmbahen Konventës evropiane për gjuhët e pakicave dhe sidomos faktit se shqiptarët janë element përbërës në formimin dhe ekzistencën e shtetit maqedonas. Nga kjo qasje miratimi i këtij Ligji mund të konsiderohet si një “lëshim”, që maqedonasit u bëjnë shqiptarëve, pavarësisht faktit se juridikisht të dyja palët janë pjesë përbërëse sine qua non e shtetit maqedonas dhe e qeverisin bashkë. Kjo për faktin se shqiptarët, ndryshe nga pakicat e tjera të cituara më lart, janë element shtetformues si dhe maqedonasit.

6. Gjuha shqipe zyrtare në përdorim midis nivelit qendror dhe atij vendor

Çështja bëhet edhe më e qashtë nëse shtrojmë pyetjen për të drejtat natyrore gjuhësore të shqiptarëve në shtetin e MV. Ky ligj nuk jep një përgjigje ad hoc. Sepse në fakt shqiptarët përfitojnë të drejta gjuhësore në nivele qendrore dhe vendore vetëm në ato territore ku ata përbëjnë 20% të banorëve rezidentë. Ja se çfarë thuhet në ligj: “Në të gjitha organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, organizata dhe ente, komisione gjuhë zyrtare përveç gjuhës maqedonase dhe shkrimit të saj është edhe gjuha që flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Mirëpo, tinëzisht, më tej në ligj thuhet se “Në njësitë e vetqeverisjes lokale gjuha dhe shkrimi që e përdorin më së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabetin që e përdorin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetvendosjes lokale, vendosin organet e njërive të vetqeverisjes lokale. Kjo do të thotë se aty ku shqiptarët janë më pak se 20% vetëm po deshën maqedonasit ata mund të përfitojnë të drejtën e përdorimit të gjuhës shqipe.

Sidoqoftë, është fakt se pothuajse gjithë problematika e qytetarëve ushtrohet në territorin vendor. Më shqip, kjo do të thotë se realisht ky ligj nuk ua njeh të drejtën e përdorimit të gjuhës shqiptarëve duke marrë si kriter 20 % në plan shtetëror, kudo ku ata ndodhen, por vetëm në ato territore të vetadministrimit lokal, ku ata përbëjnë 20%. Po si i bëhet për ato komuna ku shqiptarët janë më pak se 20%, bie fjala 19%, 18% apo 15%?

Nga ana tjetër, nëpërmjet këtij ligji krijohet një problematikë e rëndë sociale që ka të bëjë me lëvizjen e lirë të qytetarëve në territor, pasi cenohet lëvizja e lirë demografike e shqiptarëve në hapësirën shtetërore maqedonase, sidomos në ato territore ku ata nuk përbëjnë 20% ngase u duhet të përballen me murin gjuhësor të vetëm gjuhës maqedonase zyrtare dhe humbin të drejtën që kishin për gjuhën e tyre në territorin ku ishin 20%.

Jam i mendimit se e vetmja zgjidhje e drejtë është njohja e përdorimit të gjuhës shqipe në gjithë shtrirjen shtetërore, pavarësisht faktit nëse në disa komuna ata janë më pak ose më shumë se 20%, dhe ky kriter të mos jetë kushtëzues për komunat, ku shqiptarët janë më pak se 20%. Kjo sepse ushtrimi i të drejtës së përdorimit të gjuhës nga niveli qendror në atë vendor lë jashtë territore ku shqiptarët janë rezidentë me më pak se 20% dhe nuk ka arsye t’i luten përsëri shumicës maqedonase vendore për të ‘vënë dorën në zemër’. Kësisoj Ligji duhet të parashikojë në nivel vendor që, aty ku përmbushen kushtet sipas ligjit për Arsimin Parauniversitar në RMV për mësimdhënie në gjuhën shqipe, ajo të realizohet pavarësisht faktit nëse plotësohet apo jo në atë komunë kriteri numerik 20%. Duhet të prevalojë pra mbi Ligjin për Gjuhët, si e drejtë universale, e drejta për arsimim në gjuhën amtare sipas Ligjit të Arsimit Parauniversitar. E drejta për arsimim në gjuhën amtare është një e drejtë natyrore që lidhet me arsyen e qenësisë së qenies njerëzore. Është e drejtë themelore, jashtë çdo ideologjie e ca më pak e varur nga kritere numerike, si rasti në fjalë. E drejta themelore njerëzore, ku futet edhe gjuha, para se të jetë një e drejtë shtetërore ajo është një e drejtë në thelb, që buron prej vetë ekzistencës së qenies. Dhe shtetet me demokraci funksionale ngrihen mbi këto themele.

Prandaj shqiptarët duhet të heqin dorë nga kompleksi i inferioritetit në raport me fqinjët. Ne duhet të heqim dorë nga mendësia për ta konsideruar si fitore një të drejtë natyrore, për më tepër kur ajo është e sanksionuar në konventat ndërkombëtare të shteteve me demokraci funksionale. Liria, ushtrimi dhe mbrojtja e të drejtave të kombësive të tjera nuk duhet të shndërrohet as në paragjykime e as në lëshime për shkak të trysnive të jashtme. Të drejtat themelore janë të drejta natyrore; janë realitete që demokracitë funksionale i trajtojnë si

produkte institucionale për bashkëjetesën e etnive, të gjuhëve dhe kulturave si dhe për përfitimin e ndërsjellë të gjithë shoqërisë urbane.

Në përfundim mund të them se për sa i përket gjuhës shqipe në RMV ka ende shumë rrugë për të bërë, por mbudhja duhet të nisë prej të kuptuarit e krijimit të vetëdijes së nevojshme të shoqërisë urbane e, mandej, të ndryshuarit dhe të zbatuarit të Ligjit për Gjuhët. Mbi këtë mendësi duhet edhe të funksionojnë Agjensia, Inspektorati dhe të gjitha institucionet e tjera të ngarkuara me zbatimin e ligjit, ku vendimmarrja shtetërore duhet të mbështetet në institucione akademike të përgjegjshme më mirë sesa në koniunktura individësh.

Bibliografia

Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ratifikuar me ligjin nr.8496, datë 3.6.1999.

Kushtetuta e RM-së, amendamenti v, neni 1, 2001.

Ligji për përdorimin e gjuhëve në RMV, 2019.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit, 2001.

James Pardew, Peacemakers. American Leadership and the End of Genocide in the Balkans, 2018.